VENDIM
Nr. 27, datë 15.2.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 16 pika 7, dhe 47 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", si dhe neneve 15 dhe 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të "Programit të Përputhshmërisë Rregullatore" (RCP),

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e "Programit të Përputhshmërisë Rregullatore" (RCP).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti